



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 836 / Prot. 6

Tiranë, më 23/11 /2016

REKOMANDIM

Nr. 32 , datë 23/11 /2016

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, si dhe neneve 77-112 të Ligjit 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave në ngarkim të kontrolluesit "**Drejtoria e Policisë së Shtetit**", Tiranë

KONSTATOVA:

Në zbatim të Urdhrit nr. 198, datë 20/09/2016, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit, "**Drejtoria e Policisë së Shtetit**", me objekt:

- *Verifikimi i ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga personi me initiale M.P. në kuadër të verifikimit të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale të tij, të bëra publike edhe në media, në zbatim të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar;*

Hetimi administrativ pranë kontrolluesit është iniciuar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga personi me initiale M.P (në cilësinë e dëshmitarit të përfshirë në një çështje hetimore), nëpërmjet të cilës pretendonte se një televizion kombëtar ka publikuar të dhënat e tij personale (pa miratimin e tij), konkretisht dokumentet zyrtare të siguruar nga sistemi TIMS (foto dhe lëvizjet), nëpërmjet kronikave në lajme, emision, portalit online dhe artikuj.

Pala ankuese ka paraqitur në cilësinë e provës artikujt përkatës marrë nga portali online dhe faja e emisionit në Facebook ku rezultojnë të jetë publikuar fotoja dhe një dokument nga sistemi TIMS mbi lëvizjet e ankuesit.

Sistemi TIMS është një bazë të dhënash elektronike që administrohet nga "**Drejtoria e Policisë së Shtetit**" në cilësinë e kontrolluesit.

Kontrolluesi "**Drejtoria e Policisë së Shtetit**" gjatë veprimtarisë së tij në kuadër të ruajtjes së rendit dhe të sigurisë publike, parandalimin dhe zbulimin e krimeve (neni 3/ ligji 8792, datë 10/05/2001, Për krijimin e Qendrës së Përpunimit të të Dhënave), mbledh, përpunon dhe trajton të dhëna personale në Qendrën e Përpunimit të të Dhënave (strukturë e kontrolluesit)

përmes disa sistemeve të Teknologjisë së Informacionit. Një ndër këto sisteme nën administrim të kontrolluesit, që menaxhon të dhënat e hyrje-daljeve nga Republika e Shqipërisë të subjekteve të të dhënave është Sistemi i Menaxhimit Total të Informacionit – TIMS. Ky sistem informatik është ndërtuar dhe mirëmbahet teknikisht nga Drejtoria e IT-së në varësi të kontrolluesit.

1. Zyra e Komisionerit gjatë hetimit administrativ konstatoi se kontrolluesi Drejtoria e Policisë së Shtetit, gjatë përpunimit të të dhënave në sistemin TIMS, zbaton kriteret e ligjit nr.8792, datë 10/05/2001 “Për Krijimin e Qendrës së Përpunimit të të Dhënave”, Rregulloren “Për mbrojtjen e të dhënave personale dhe sigurinë e tyre në policinë e shtetit” (miratuar me Urdhrin e Ministrit të Brendshëm nr. 330, datë 04.07.2011) dhe Manualin e përdorimit të sistemit TIMS. Në këto akte parashikohen masa konkrete sigurie për përdorimin e sistemit, në përputhje me nenin 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar;

Kontrolluesi ka miratuar Deklaratën e Konfidencialitetit që plotësohet dhe nënshkruhet nga punonjësit e policisë (me status policor dhe civil), dhe ka si qëllim garantimin e konfidencialitetit të informacionit dhe mos përhapjen ndaj personave të paautorizuar, në përputhje me nenin 28 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

Kontrolluesi zbaton masa sigurie për ruajtjen e bazës së të dhënave të sistemit TIMS në një ambient me kushte të përshtatshme dhe ndalon aksesin e paautorizuar në këtë sistem. Sistemi nuk është i cenueshëm nga sulmet nga jashtë.

Zyra e Komisionerit vlerëson se ekzistenca e bazës ligjore mbi sigurinë e sistemit TIMS është i rëndësishëm për kontrolluesin pasi përbën bazën e referimit për çdo përpunim të të dhënave dhe përcakton standartet ligjore për garantimin e një përpunimi të ligjshëm dhe të sigurtë të të dhënave personale.

2. Zyra e Komisionerit, në kuadër të trajtimit të ankesës, konstatoi se të dhënat e hyrje-daljeve të subjektit të të dhënave M.P dhe foto e tij e publikuar në media në datë 20 Prill 2016, janë të njëjta me të dhënat që tregon sistemi TIMS në atë datë. Ky konstatim përforcon bindjen se të dhënat e publikuara në media janë siguruar nga sistemi TIMS.

Gjithashtu, gjatë hetimit administrativ është konstatuar ekzistenca e disa marrëveshjeve bashkëpunimi “Për dhënien e të drejtës së përdorimit të sistemit të menaxhimit total të informacionit (TIMS) të policisë së shtetit” të nënshkruara midis Drejtorisë së Policisë së Shtetit dhe disa institucione si Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Shërbimi Informativ Shtetëror dhe Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit e Pastrimit të Parave. Nëpërmjet këtyre marrëveshjeve institucionet lejohen që të aksesojnë të dhëna personale të shtetasve shqiptarë nëpërmjet sistemit TIMS. Në këto marrëveshje janë përfshirë kushtet, detyrimet dhe përgjegjësia administrative dhe penale e personave që autorizohen të kenë akses në sistem, për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mospërhapjen e informacionit.

Gjatë hetimit nuk u arrit të evidentohet subjekti ose institucioni që ka përhapur të dhënat e sistemit TIMS, dhe në këtë kuadër Zyra e Komisionerit vlerëson si të nevojshme përforcimin e masave lidhur me gjurmueshmërinë e veprimeve në sistemin TIMS pasi kjo lidhet pazgjidhshmërisht me garantimin e sigurisë së të dhënave që përpunohen nëpërmjet tij dhe ruajtjen e konfidencialitetit, në kuadër të respektimit të nenit 27 dhe 28 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar.

Për shkeljet e konstatuara është mbajtur procesverballi i konstatimit në momentin e ushtrimit të hetimit administrativ (që mban datën 13.10.2016). Një kopje e procesverballit iu dorëzua kontrolluesit.

Lidhur me pretendimet e kontrolluesit të paraqitura edhe në seancën dëgjimore të datës 31.10.2016, Zyra e Komisionarit vlerëson se pavarësisht se kontrolluesi ka një bazë të mirëfilltë ligjore në kuadër të garantimit të sigurisë dhe konfidencialitetit të të dhënave të përpunuara në sistemin TIMS, është e nevojshme që të merren masa konkrete teknike në kuadër të rritjes së kapaciteteve dhe performancës së sistemit.

Sa më sipër,

Në zbatim të neneve 29, 30, 31 pika 1/ "a/1" dhe 32/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar,

REKOMANDOJ:

1. Në zbatim të nenit 5/1/d të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar, të përcaktohen afate konkrete për funksionimin dhe gjurmueshmërinë e sistemit TIMS, në përputhje me qëllimin ose qëllimet ligjore të përpunimit.
2. Në zbatim të nenit 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar, të përmirësohen kapacitetet teknike të sistemit TIMS në kuadër të realizimit të gjurmueshmërisë.
3. Në zbatim të nenit 28 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar, të merren masa konkrete teknike në kuadër të garantimit dhe ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave që përpunohen në sistemin TIMS nga ana e personave që kanë akses, me qëllim shmangien e rasteve abuzive të publikimit dhe përhapjes së paligjshme të të dhënave.
4. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar, të kryhet plotësimi i detyrimeve të parashikuara në pikën 2 dhe 3 të këtij Rekomandimi, brenda një afati një vjeçar nga momenti i marrjes dijeni. Pas këtij afati të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale mbi masat e marra në zbatim të Rekomandimit të mbështetura nga aktet përkatëse.

5. Plotësimi i këtyre detyrimeve ligjore mund të jetë objekt kontrolli në vazhdimësi nga Zyra e Komisionerit.
6. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht, në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 23 / 11 / 2016

